



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERTA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /  
GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E EKONOMISE/ MINISTARSTVO  
EKONOMIJE/  
MINISTRY OF ECONOMY

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës/ Geološka  
Sluzba za Kosovo/ Geological Survey of  
Kosovo

<b>DATA:</b>	29.01.2024
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Agjencinë Kundër Korruptionit/AKK
<b>CC:</b>	Luan Morina, Ud. Drejtore Ekzekutiv, SHGJK
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Flutra Smakiqi-Thaçi, Zyrtare përgjegjëse per Sinjalizim, SHGJK
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Raporti 6 ( gjashtë ) Mujor: Korrik – Dhjetor 2023



Të nderuar,

Bazuar në nenin 29, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, po ua përcjell raportin 6 mujor, Korrik Dhjetor 2023, lidhur me sinjalizimin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Ministria e Ekonomisë.

1	Numri i raportimeve dhe Shpalosjeve në interes publik;	1 - Pretendim për veprime të kundërligjshme për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e zyrtarëve të caktuar të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës në lidhje me projektin/ kontratën ‘Laboratori i IGJK’
2	Veprimet e ndërmarra në lidhje me ato raportime apo shpalosje	1. Fillimisht , referuar komunikimeve përmes emalit me datën 06.07.2023 , është bëre sinjalizimit i pare nga punëdhënësi, ka dërguar një emal njoftues tek Zyrtarja përgjegjës për sinjalizim, për përcjelljen e aktivitetet/ dyshimeve potencialisht të ngritura të cilat lidhen me veprime të kundërligjshme për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e

		<p>zyrtarëve të caktuar të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës në lidhje me projektin/ kontratën ‘Laboratori i IGJK’</p> <p>2.Me datën 07 dhe 11 Korrik 2023, nga zyrtari janë dërguar dy raportet të sinjalizimit për të njëjtë raste /situatë.</p> <p>3.Referuar njoftimeve/ sinjalizimeve dhe dyshimit për ndodhjen potencialisht në konflikt te interesit Zyrtarja përgjegjës për sinjalizim ka kontaktuar me Agjenionin Kundër Korrupsion (AKK) për tu sqaruar rreth konfliktin potencial të interesit, ngase ishte edhe vete pjesë e komisionit për hartimin e termave të referencës per pjesën e projektin/ kontratën “Laboratori i IGJK”, përkatësisht pjesën e rrjetit sizmike.</p>
3	Aktivitete e ndërmarrë nga Institucioni i juaj lidhur me sinjalizimin;	<p>1.Pas sqarimeve të marra nga AKK, Zyrtarja përgjegjëse për Sinjalizim ka njoftuar punëdhënësit përmes komunikimit elektronik për pamundësinë për trajtimin e rastit/ sinjalizimit në fjalë, ngase sipas sqarimit me AKK, potencialisht mund të ndodhje në konflikt të interesit.</p> <p>2.Pas marrjes së këtij njoftimi nga Zyrtarja përgjegjëse për sinjalizim, punëdhënësi ka kontaktuar me AKK në mënyre që të sqarohet se cila është rruga tutje në adresimin e këtij rasti/ sinjalizimi.</p> <p>3.Pas sqarimeve nga AKK, punëdhënësi ka filluar procesin e hetimit administrative për trajtimin e rastit në fjalë.</p>

		<p>4.Mirëpo gjatë shqyrtimit preliminare të dokumente, janë hasur komunikime të cilat potencialisht edhe punëdhënësin e kanë vendosur në pozitën e konfliktit potencial të interesit.</p>
4	Bashkëpunimi me projektet apo organizatat e tjera;	<p>1. Me pas është kontaktuar prap AKK, me të cilën është sqaruar dhe vërtetuar se edhe punëdhënësi potencialisht mund të konsiderohet të jetë në pozitën e konfliktit të interesit dhe si rrjedhojë rasti ka kaluar për tu trajtuar nga AKK, me kërkesën se çdo informacion që është apo gjenerohet në proces të njoftohet AKK.</p> <p>2.Në ndërkohë, punëdhënësi është njoftuar nga njësia e prokurimit në ME, se qenka filluar procesi hetimore për projektin / kontratën "Laboratori i IGJK" dhe nga njësia përgjegjëse e Policisë së Kosovës, i janë kërkuar dokumentet relevante që lidhen me projektin në fjalë.</p> <p>3.Si rezultat i kësaj informate, punëdhënësi ka njoftojua AKK, e cila pas shqyrtimit të informacionit ka njoftuar me shkrese me nr. 1798/23 të datës 29.09.2023 (bashkëlidhur) se "Mbylllet rastin lidhur me informacionin e pranuar nga ana e juaj me pretendimin për veprime të kundërligjshme për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e zyrtarëve të caktuar të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës në lidhje me projektin/ kontratën "Laboratori i IGJK"</p> <p>Ngase tani e tutje rasti do të trajtohet nga Drejtoria për hetimin e Krimeve Ekonomik dhe korruption - Policia e Kosovës, në</p>

		bazë të autorizimeve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë
5	Gjinia	Mashkull



REPUBLIKA E KOSOVËS  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT



DATË/A:	29.09.2023	02/03	748/23
REFERENC-Ë:	AKK-02-03-1677/23	02	29-09-2023
PËR/ZA/TO:	z. Luan Morina, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv-Shërbimi Gjeologjik i Kosovës		
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit	<i>Yll Buleshkaj</i>	
NGA/OD/FROM:	Blerim Kelmendi, Drejtor i Departamentit për Lutimin e Korruptionit në Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit	<i>Blerim Kelmendi</i>	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim		

Inderuari z. Morina,

Mbi bazën e informacioneve tuaja, në kuptim të dispozitës së nenit 16 paragrafi 2, si dhe nenit 18 (paragrafi 2), të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, ju:

**NJOFTOJMË se:**

Mbylljet rasti, lidhur me informacionin e pranuar nga ana e juaj me pretendimin për veprime të kundërligjshme për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e zyrtarëve të caktuar të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, në lidhje me Projektin/Kontratën “Laboratori i IGJK”.

Në bazë të dokumentacionit të bashkangjitur, konkretisht shkresës suaj, njoftohemi se lidhur me projektin “Laboratori i IGJK-“, janë duke u zhvilluar hetime nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korruptionit - Policia e Kosovës, në bazë të Autorizimit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Lidhur me këtë, përmes kërkesës për konfirmim, kemi kërkuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, informacion zyrtar se a janë duke u zhvilluar hetime nga ana e tyre, në lidhje me Projektin/Kontratën “Laboratori i IGJK”, me nr. 213-22-6335-1-1-1, në mënyrë që lënda e njëjtë të mos hetohet në të njëjtën kohë nga dy institucione, të mos zhvillohen dy procedura të ndara, dhe me qëllim të bashkërendimit të aktivitetave për hetimin administrativ të informatës së raportuar në Agjenci, prej nga edhe kemi marr konfirmimin se i njëjti rast është duke u trajtuar në kuadër të kësaj prokurorie.

Bazuar në nenin 16 (paragrafi 9) të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Punëdhënësi në kuadër të një institucioni, në qoftë se arrin në konstatime se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore, ka obligim:

Paragrafi 9 "Nëse në përfundim të procesit të hetimit administrativ të sinjalizimit nga punëdhënësi, rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore sipas ligjit, punëdhënësi vë në dijeni organin kompetent."

Po ashtu, në rast të konstatimit për veprime ose praktikë të dyshuar të sinjalizimit, e cila përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore, në procedurë të hetimit administrativ të sinjalizimit të jashtëm. Agjencia duhet të veprojë sipas të njëjtës dispozitë dhe ta përcjellë rastin tek organi kompetent, që tashmë rezulton veçse i njëjti rast është duke u trajtuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Duke pasur parasysh këtë, si dhe faktin se pretendimet e ngritura tejkalojnë kompetencat ligjore dhe mundësitet reale për hetim administrativ të tyre nga Agjencia, në kuadër të procedurës së sinjalizimit të jashtëm, dhe për faktin e konsfimuar se rasti i njëjtë është duke u trajtuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në kuadër të procedurës penale, mbylljet rasti dhe pushohet procedura e sinjalizimit, bazuar në nenin 16 (paragrafi 11) të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në ndërlidhje me nenin 97 (paragrafi 1) të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.